



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 37

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

Prishtinë, më 29 korrik 2016, në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka, Besa Baftiu dhe Adem Hoxha.

Munguan: Mirjeta Kalludra, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Fjolla UKA-KDI dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.7.2016;
3. Shqyrtim i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.7.2016;

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18.7.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtim i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Kryetarja – Siç e dini, kjo marrëveshje është proceduar për herë të dytë në Kuvend, pasi që nuk i mori votat dhe nuk është ratifikuar. Ashtu siç jemi dakorduar në mbledhjen e fundit, ne si kryesi e Komisionit, kemi realizuar një takim me ministrin e Financave dhe kemi biseduar lidhur me këtë marrëveshje, në veçanti për aneksin e kësaj marrëveshjeje, që është vlerësuar si shumë e lartë. Pra, edhe vërejtjet nga ana e deputeteve, pikërisht kanë qenë për këtë çështje edhe gjatë shqyrtimit të parë, edhe gjatë shqyrtimit apo raportimit të ministrit të Shëndetësisë në Komision. Ministri i Financave na tha se nuk ka mundësi ndryshimi, mirëpo u diskutua që të bëhet monitorim i vazhdueshëm gjatë implementimit, pra shpenzimit të mjeteve të kësaj marrëveshjeje. Ne, si Komision, konsiderojmë se duhet të kërkojmë që, si Komision apo bashkërisht edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa, të monitorojmë zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Një marrëveshje e cila është nënshkruar nga ana e dy presidentëve, në këtë rast, mes Presidentes sonë, znj. Jahjaga dhe Presidentit të Austrisë, pra një marrëveshje e nënshkruar me një shtet që financon mjaftë projekte, qoftë me kredi të buta, qoftë si donacione për Kosovën, e të mos ratifikohet një marrëveshje që gjithsesi i duhet sektorit të shëndetësisë, e cila njëherësh planifikon ngritjen e kuadrove, që do të punojnë me këtë pajisje në Klinikën e Kardiologjisë Invazive, e cila është shumë e rëndësishme, ku kemi harxhuar shumë buxhet, duke i mjekuar pacientët jashtë vendit. Pra, si Komision, është kërkuar që të japim një rekomandim lidhur me këtë marrëveshje, andaj e hapi diskutimin. Unë, personalisht, jam që kjo marrëveshje të procedohet dhe të votohet. Urdhëroni z. Baxhaku.

Hatim Baxhaku – Ju faleminderit kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë, përshëndetje për gjithë pjesëmarrësit tjerë! Pra, ashtu siç e potencoi edhe kryetarja, ne kemi realizuar takim me ministrin e Financave, i cili tha se ekzistojnë të gjitha mundësitë që të kontrollohet shpenzimi i kësaj pjesë apo aneksi në vlerë prej 500 000 €. Pra, duke krijuar një komision, i cili do të përcjellë implementimin e kësaj marrëveshjeje. Unë vlerësoj se këtë marrëveshje, si Komision, duhet ta përkrahim që të procedohet në Kuvend dhe të votohet edhe për një arsye të madhe, se kjo marrëveshje është pjesë e marrëveshjes tjetër në vlerë prej 20 milionë euro. Mosratifikimi i kësaj marrëveshjeje e rrezikon implementimin e gjithë marrëveshjes në vlerë prej 20 milionë euro. Unë, po ashtu, kam diskutuar edhe me ministrin e Shëndetësisë, i cili tha se, si Komision, mund edhe të kërkojmë që kjo marrëveshje të procedohet edhe pa këtë aneksin, mirëpo duhet ta kemi parasysh se kjo aparaturë peshon 9 tonë kg, kështu që ambienti për vendosjen duhet të jetë shumë i sigurt. Po ashtu, koronarografi nuk është duke funksionuar, që një kohë dhe të gjithë pacientët janë duke marrë shërbime në institucionet private. Unë mendoj që këtë marrëveshje duhet

ta mbështesim dhe të llobojmë që të ratifikohet në Kuvend dhe pastaj të shqyrtojmë mundësinë sesi do ta monitorojmë zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Kryetarja – Duke analizuar këtë marrëveshje, edhe diskutimin që e patëm me ministrin, nuk është e thënë që të gjitha mjetet e kësaj kredie të shpenzohen, nëse nuk ka nevojë. Pra, do të shpenzohen vetëm ato mjete që kanë nevojë. A ka dikush tjetër të shtojë diçka? Urdhëroni znj. Baftiu!

Besa Baftiu – Faleminderit kryetare!

Përsëritet të nderuar kolegë deputetë dhe ju media! U diskutua dhe është folur shumë rreth kësaj marrëveshjeje, si në Kuvend, po ashtu edhe në Komision, pra dy herë është diskutuar në Komision me ministrin. Unë nuk kam qenë prezent, mirëpo në bazë të asaj që është prezantuar nëpër media dhe në bazë të procesverbaleve që i kam lexuar, kemi vërejtur se kjo marrëveshje ka pasur një dilemë tek anëtarët e Komisionit, që do të thotë se edhe tek ne kemi pasur disa dilema, mirëpo duke u nisur nga parimi që jemi për këtë marrëveshje, pra këtë kredi shumë të butë, pothuajse me 0 interes, ne e përkrahim, mirëpo duke ditur faktin se janë dhënë miliona euro në kardiokirurgji dhe kardiologji, pra janë shpenzuar shumë mjete dhe nuk dihet sesi kanë përfunduar ato, pra nuk ka dhënë llogari deri më tash. Unë mendoj se gabim i ministrit ka qenë që, së pari është dashur të raportojë se ku kanë shkuar dhe si janë investuar ato mjete. Pra, para Komisionit të japin llogari ata persona që kanë qenë përgjegjës, që deri më tani, diku 6 ose 7 milionë euro janë dhënë për funksionalizimin e kardiologjisë invazive. Siç e dimë, në vitin 2013 është prerë shiriti nga ish-ministri, z. Agani. Pra, duke pasur parasysh këto që kanë ndodhur në sektorin e shëndetësisë, me të vërtetë këto dilema që i kemi pasur ne si anëtarë të Komisionit, kanë qenë të arsyeshme. Mirëpo, me këto sqarimet që na prezantuat, pas takimit me ministrin e Financave dhe mundësinë e mbikëqyrjes nga ana e Komisionit të shumës apo vlerës prej 500 000 €. Unë mendoj se kjo mundësi e mbikëqyrjes është shumë e mirë dhe si Komision, mund ta bëjmë punën tonë dhe në vazhdimësi të përcjellim implementimin e kësaj marrëveshjeje apo kësaj shume, në vlerë prej 500 000 €, pasi që dihet se shuma tjetër do të shkojë për blerjen e aparaturës. Sa i përket trajnimit të stafit në Austri, mendimi im është që kur të vijë këtu aparatura, do të ishte më mirë që të vijnë ekspertët nga Austria këtu dhe t'i trajnojnë këtu, sesa të shkojë vetëm një grup i vogël dhe të trajnohen në Austri. Megjithatë, Lëvizja Vetëvendosje do të përkrahë këtë marrëveshje, si në Komision, po ashtu edhe në Kuvend. Pra, jemi për këtë marrëveshje, sepse kjo është në të mirë të qytetarëve. Shpresojmë që do të shfrytëzohet në formën më të mirë të mundshme. Ju faleminderit!

Kryetarja – A ka dikush tjetër, që të shtojë diçka? Urdhëroni z. Beka, pasi që keni qenë edhe ju në takim me ministrin e Financave.

Fadil Beka – Faleminderit kryetare!

Të nderuar deputetë dhe ju media! Unë do të flas jo vetëm në cilësinë e anëtarit të Komisionit, por edhe në cilësinë e mjekut. Pra, duke pasur parasysh gjendjen e kardiologjisë invazive dhe kardiokirurgjisë me pajisje, gjegjësisht me aparaturë moderne, konsideroj se si mjek s'kam as të drejtë morale, e as profesionale për të qenë kundër kësaj marrëveshjeje, prandaj edhe unë do ta mbështes këtë marrëveshje, gjithashtu e mbështes edhe propozimin që të këtë një mekanizëm monitorues të kësaj marrëveshjeje gjatë zbatimit. Ju faleminderit!

Komisioni, pas diskutimit, njëzëri e përkrahu marrëveshjen dhe nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Projektligji nr. 05/L-106, për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, Komisioni shqyrtoi Projektligji nr. 05/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG, për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit, mirëpo Komisioni, në vazhdimësi, do të monitorojë zbatimin e këtij ligji.

4. Të ndryshme

Kryetarja – A keni ndonjë çështje për të diskutuar për pikën të ndryshme? Jo, atëherë të vazhdojmë prapë me çështjen që e kemi diskutuar në mbledhjen e fundit, lidhur me shpërndarjen e mjeteve për skemat sociale, kërkesën e Postës së Kosovës.

Po ju njoftoj se ne kryesia e Komisionit, kemi aranzhuar një takim të hënën, më datë 1.8.2016, me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, z. Bedri Hamza. Pra, edhe nga ky takim do të marrim më shumë informata lidhur me këtë çështje. Kërkesën e Postës e kemi diskutuar edhe në takimin që kemi pasur me ministrin e Financave. Pra, ka lindur një ide që të shohim se si postat e rajonit i menaxhojnë këto fonde, pasi që përmes tyre shpërndahen pensionet. Meqenëse kemi organizata përkrahëse të Kuvendit, atëherë propozoj që të kërkojmë nga ato që të na përkrahin me një hulumtim dhe të na ofrojnë informata se si është praktika në këto shtete. Shpërndarjes së skemave sociale dhe praktikave të mira rajonale të shpërndarjes së skemave sociale përmes postës. Ne, si Komision, edhe herëve tjera, përmes Drejtorisë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv, kemi kërkuar nga KDI-ja, që përmes projektit për hulumtime parlamentare, të na mbështesë me hulumtime. Besojmë se edhe komisionet tjera, e praktikojnë këtë praktikë, ndërsa për ne si Komision, këto hulumtime kanë qenë të mirëseardhura. Andaj, a pajtoheni që të procedojmë këtë kërkesë për një hulumtim?

Komisioni, njëzëri, e përkrahu idenë për një hulumtim lidhur me shpërndarjen e skemave sociale.

Kryetarja – Po ashtu, me ministrin e Financave e diskutuam çështjen e mbështetjes në aspektin financiar edhe për Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent, pasi që ndryshimet që janë bërë në këtë projektligj, ka një kosto shtesë nga ajo që është proceduar në Kuvend. Në këtë rast, ministri na premtoi se do kjo çështje do të shqyrtohet dhe do të buxhetohet në buxhetin e vitit të ardhshëm. Ne, si Komision, nuk kemi pasur mundësi të parashohim koston financiare, andej në momentin kur do të shqyrtohet edhe në komisione tjera, e veçanërisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa, do të marrim pjesë dhe do t'i njoftojmë me ndryshimet që janë bërë dhe nevojën për mbështetjen e këtij projektligji.

Fikrim Damka – Faleminderit kryetare!

Të nderuar deputetë! Unë besoj se ky projektligj mund të procedohet në Kuvend edhe pa pasqyra financiare, sepse edhe herëve tjera kemi pasur praktika të tilla, pasi që ka qenë e vështirë të dihet

kostoja e saktë për të. Të njëjtën situatë e kemi edhe tash, pasi që ne nuk mund të dimë se sa do të kushtojë ndërtimi i një stacioni të emergjencave, sa njerëz do të punësohen, pasi që do të ketë shfrytëzim të hapësirave aktuale, sa do të ketë staf, sa doktorë e sa infermierë. Në këtë rast, Ministria e Financave, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë, duhet të përgatisin një projekt për emergjenca dhe të kërkojnë mbështetje financiare nga BE-ja apo donatorë tjerë për ndërtimin e sistemit të komunikimit apo zhvillimin e sistemit komplet të emergjencave.

Kryetarja— Nëse nuk keni asgjë për të shtuar te kjo pikë, e shpallim të mbyllur mbledhjen. Ju falënderojmë për kontributin!

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA